



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2022:106262  
Datë: 31.05.2024  
Numri i dokumentit: 05764301

Ac.nr.7374/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Hunaida Pasuli, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a., me seli në Prishtinë, rr. “Nëna Terezë” nr. 36, kundër debitorit I.D. nga fshati ....., Komuna e Skenderajt, lidhur me çështjen përmbarimore, për borxh, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të kreditores, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, PPP.nr.27/2020, i datës 30.06.2021, me datë 29.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditores Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a., me seli në Prishtinë, rr. “Nëna Terezë” nr. 36, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, PPP.nr.27/2020, i datës 30.06.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.27/2020 i datës 30.06.2021, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të Aprovohet pjesërisht prapësimi i debitorit I.D. nga fshati ....., Komuna e Skenderajt, ashtu që II. Shfuqizohet pjesërisht urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr. 110/2020 i datës 03.02.2020 për shumën prej 1,522.33 €, për periudhën kohore prej 18.06.2003 deri me datën 31.12.2008. Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur që të Mbetet pjesërisht në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr. 110/2020 i datës 03.02.2020, andaj për këtë pjesë të urdhrit Obligohet debitori I.D. nga fshati .... Komuna e Skenderajt, që kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), sh.a., me seli në Prishtinë, në emër të borxhit për konsumin e energjisë t’ia paguaj shumën prej 122.32 € për periudhën kohore 01.01.2009 deri me

datën 20.03.2013, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke filluar nga pranimi i këtij vendimi deri në pagesën definitive.

Kundër këtij aktvendimi i autorizuari i kreditores brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditores dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim ose të anulohet aktvendimi i atakuar dhe lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe në rivendosje, duke i evituar lëshimet e cekura më lartë si në ankesë dhe detyrohet debitori ti paguaj në emër të shpenzimit të energjisë elektrike shumë prej 1,644.65 € si dhe ti bartë shpenzimet për ankesë në lartësi sipas UA 01/2017 për taksat gjyqësore.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), ka gjetur se

Ankesa e autorizuarit të kreditores është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorja në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste me nr. DMI - .... i datës 31.01.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim me datë 03.02.2020, ndaj debitorit për shumë e detyrimit në lartësi prej 1,644.65 €, për konsumimin e energjisë elektrike të krijuar nga data 18.06.2003 deri me datën 20.03.2013, në afat prej 7 ditësh prej ditës së pranimit të këtij vendimi, me kamatë 8% nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit.

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditores të datës 03.02.2020, ka nxjerrë Urdhrin Përmbarimor me shenjë P.nr.110/20 i datës 03.02.2020, me të cilën e ka lejuar përmbarimin sipas Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste me nr. DMI - 46166 i datës 31.01.2020, duke e pranuar si dokument të besueshëm, e cila i plotëson kushtet për ta lejuar përmbarimin.

Kundër Urdhrit përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 11.02.2020, duke propozuar që të Aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe urdhri për lejimin e përmbarimit të propozuar nga Përmbaruesi Privat të anulohet në tërësi si i pabazuar dhe të prishen veprimet e ndërmarra ngase ky borxh është i pambështetur në prova sepse edhe ka parashkrim - vjetërsim të borxhit.

Me përgjigje në prapësim të datës 24.02.2020, i autorizuari i kreditores ka theksuar se bazuar në argumentet e mësipërme, kundërshtimi i debitorit është i paargumentuar dhe i pabazuar, andaj ka propozuar që të mbetet në fuqi Urdhri i Përmbaruesit Privat për caktimin e përmbarimit dhe nëse gjykata kompetente edhe pas kësaj përgjigje në prapësim nga kreditorja nuk është qartësuar për validitetin dhe domethënien e përgjigjes së kreditorit kanë propozuar që në kuptim të nenit 73 të LPP-së, të caktohet seancë publike në këtë çështje.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e atakuar PPP.nr. 27/2019, të datës 30.06.2021, ka vendos që ta aprovoj pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e shfuqizuar pjesërisht Urdhrin Përmbarimor, P.nr.110/2020, datë 03.02.2020 dhe duke e lënë në fuqi pjesërisht urdhrin për lejimin e përmbarimit në shumë prej 122.32 €, më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në zbatim të dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, ka vlerësuar prapësimin e debitorit dhe ka gjetur se i njëjti është pjesërisht i bazuar. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqet sipas nenit 69 dhe 71 të LPP-së, sipas të cilave do të pengohet në tërësi përmbarimi i lejuar i përmbaruesit privat. Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe pretendimeve të debitorit në prapësim dhe kreditores në përgjigje në prapësim, ka gjetur se pretendimet e debitorit për parashkrim janë pjesërisht të bazuara për faktin se borxhi i krijuar për periudhën 18.06.2003 e deri me datën 31.12.2008 është borxh i parashkruar, ndërsa për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me datën 08.05.2013 e për të cilin obligim janë pajtuar që të paguhet me këste mujore në shumë prej 20 € dhe atë e ndarë në 16 këste, ka vlerësuar se për këtë periudhë kohore nuk kemi parashkrim, prandaj edhe e ka obliguar debitorin që të bëjë pagesën e mbetur ndaj kreditores në shumë prej 122.32 € pasi që i njëjti i ka paguar 10 këste në shumën prej 200 € dhe për këtë arsye edhe gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në pikën III, të dispozitivit të aktvendimit të atakuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 3, 21, 29 paragraf 1, pika 1.2 dhe paragraf 3, 69, 71 dhe 73 paragraf 3 të LPP-së, lidhur me nenin 360 paragraf 1 dhe 2, 369, 373 paragraf 1 dhe 2 dhe 382 paragraf 1 dhe 2 të LMD-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të kreditores se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për aprovimin e pjesshëm të prapësimin e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet.

Drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar dhe konstatuar gjendja faktike dhe aktvendimi i atakuar nuk përmban as shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore dhe Ligjit të Procedurës Kontestimore sipas pretendimeve ankimore të kreditores përmes ankesës së paraqitur.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike përmbarimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht, duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Pretendimi ankimor i kreditorit se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore, pa specifikuar shkeljet e pretenduara, me arsyetimin se ekstrakti në bazë të cilës është lejuar përmbarimi, është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pabazuar, për shkak se me nenin 21 të LPP-së, përcaktohet se “ Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të

besueshëm, po qe se më këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”. Në kuptim të kësaj dispozite nënkuptojmë se organi përmbarues duhet të vendos brenda kufijve të titullit përmbarues, ndërsa me rastin e vendosjes për prapësimin e debitorit, gjykata është dashur të vlerësoj se a ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së, dhe se arsyetimi i gjykatës si në arsyetimin e aktvendimit të atakuar në këtë fazë të procedurës, është i drejtë dhe i bazuar në dispozitat e LPP-së.

Me nenin 29 paragrafi 1 pika 1.2 e LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në to holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është ... ekstraktet e verifikuara nga librat afariste”. Në këtë rast në shkresat e lëndës si provë materiale përveç tjerash gjendet ekstrakti i verifikuar nga librat afariste nr. DMI - 46166 i datës 31.01.2020.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, se me rastin e pranimit të pjeshëm të prapësimin të palës debitorë të paraqitur kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, P.nr. 110/2020 i datës 03.02.2020, sepse gjykata i ka vlerësuar rrethanat e lartcekura në kuadër të provave që i ka pasur në dispozicion në momentin e vendosjes sipas prapësimin.

Gjykata e shkallës së parë me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar duke e pranuar pjesërisht të bazuar prapësimin e debitorit dhe duke shfuqizuar pjesërisht Urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.110/2020 të datës 03.02.2020, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, për arsye se në bazë të kontratës për pagesën e borxhit të lidhur në mes të kreditorit dhe debitorit, në nenin 3, parashihet se “Në rastet kur personi shkakton tri vonesa lidhur me pagesat sipas programit të pagesës së borxhit sipas marrëveshjes, pjesa e paguar e borxhit i fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet”, mirëpo në këtë rast nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga kontrata vërehet se kreditori dhe debitori janë pajtuar për pagesën e borxhit për periudhën kohore nga data 01.01.2009 deri me datën 08.05.2013, ndërsa obligimi i debitorit ndaj kreditorës është 322.32 €, për të cilën shumë janë pajtuar që të paguhet me këste mujore në shumën prej 20 € dhe atë të ndarë në 16 këste, ndërsa në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afariste shihet se debitori nga data e lidhjes së marrëveshjes ka bërë pagesën vetëm të 10 kësteve në shumë prej 20 €, sipas Kontratës për pagesën e borxhit dhe Deklaratës mbi Dakordinin e borxhit.

Në këtë rast gjykata ka konstatuar se kemi të bëjmë në parashkrim të borxhit në shumën prej 1,522.33 €, për periudhën kohore nga data 18.06.2003 deri me datën 31.12.2008 për shkak se ka kaluar afati 1 vjeçar brenda të cilit ka mundur të kërkohet pagesa, pasi që propozimi për përmbarim është paraqitur me datën 03.02.2020, ndërsa në Deklaratën mbi dakordinin e borxhit të datës 25.08.2016 dhe kontratën mbi pagesën e borxhit, periudha kohore e lartcekur nuk përfshihet si obligim i debitorit ndaj kreditorës, ndërsa pagesat e bëra sipas Deklaratës mbi dakordinin e borxhit për periudhën kohore 01.01.2009 deri më 08.05.2013 e ndërprerjen parashkrimit në shumën e borxhit prej 322.32 € dhe për këtë periudhë kohore kreditorja dhe debitori janë pajtuar që kjo shumë të paguhet me këste mujore prej 20 € në muaj, ashtu që në këtë rast nuk kemi parashkrim të borxhit, prandaj edhe është obliguar debitori që të bëjë pagesën e mbetur ndaj kreditorës në shumën prej 122.32 €, pasi që i njëjti i ka paguar 10 këste, përkatësisht shumën prej 200 €.

Me nenin 360 paragraf 1, pika 1.1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077), përcaktohet se “Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti Kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”.

Me nenin 368 paragraf 1 të këtij ligji përcaktohet se “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se “Pranimi i borxhit mund të

bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthorë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”.

Me nenin 373 paragraf 1 të këtij ligji, përcaktohet se “Pas ndërprerjes së parashkrimi fillon të rrjedh përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim”, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedh përsëri nga pranimi (pohimi)”.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se “ Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përrjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohen nga Gjykata”, pasi që është në diskrecionin e gjykatës që të vlerësojë se në cilat raste të caktojë seancë dhe se në këtë rast nuk ka qenë i domosdoshëm caktimi i seancës për shkak se nga provat e paraqitura në shkresat e lëndës, ka qenë e mjaftueshme që të vërtetohen të gjitha faktet e nevojshme për të vendosur dhe për të vlerësuar arsyet e theksuara në prapësim.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të atakuar ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, më të cilën është paraparë së në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyët e paraqitura ë në pajtim me dispozitat ë nënit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, ë lidhur më nënin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA Ë APËLIT Ë KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr. 7374/22, më datë 29.05.2024

Gjyqtarja

Hunaida Pasuli,